



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 534/23 Datë: 19/04/2023

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tutje KShC), në mbledhjen e 111-të, të mbajtur me datë 14.04.2023, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit të Kolegjit “Rezonanca”, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 -30 shtator 2026):
  - *Stomatologji Dr. Dent* MA, 300 ECTS, me kuotën, maksimum 85 studentë për vit akademik.
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Kolegji “Rezonanca”, që deri më datë 15.11.2023 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji “Rezonanca”, të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programit të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KShC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Kolegji “Rezonanca” ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1869/22 datë 31.10.2022 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tutje AKA) për riakreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
I	Stomatologji Dr. Dent MA, 300 ECTS, Riakreditim	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Venera Bimbashi</li> <li>• Luljeta Ferizi Shabani</li> <li>• Dashnor Bukleta</li> <li>• Shefqet Mrasori</li> <li>• Agron Bytyqi</li> </ul>

Me qëllim të vlerësimit të programit të studimit, AKA me datë 14.03.2023 ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin “Rezonanca” për programin, me këtë përbërje: Joke Denekens, Adrian Stan, Nibal Sabri.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit, për programin, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimin si në vijim:



- Për programin e studimit *Stomatologji Dr. Dent MA, 300 ECTS, Riakreditim*, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4), substancialisht tre (3) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 111-të, të mbajtur me datë 14.04.2023 ka shqyrtuar aplikacionin/kërkesën e Kolegjit “Rezonanca” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike: Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit “Rezonanca”,
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

  
  
 Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi  
 Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë